

Policia jep detaje për shpërthimin e granatës në Prishtinë

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

22/06/2022 15:03



Rreth orës 06:30, është raportuar se në rrugën "Dalmatët" në Prishtinë , një veturë është dëmtuar nga një mjet i dyshuar shpërthyes.

Kështu ka bërë të ditur zëdhënësi i Policisë për rajonin e Prishtinës, Agron Borovci, raporton lajmi.net.

“Dyshohet që nga shpërthimi të jenë prekur edhe dy vetura të tjera të parkuara përreth. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes, dhe nga informacionet e para dyshohet që ngjarja të ketë ndodhur rreth orës 03:00 , ndërkohë që nuk raportohet për të lënduar”, ka thënë Borovci.

“Dëmet materiale dyshohet të kenë ardhur si pasojë e shpërthimit të mjetit shpërthyes që dyshohet të jetë granatë dore. Aktualisht policia ka nisur ndërmarrjen e veprimeve hetimore për sqarimin e plotë të rrethanave që karakterizojnë ngjarjen”. **/Lajmi.net/**

Artikuj të ngjashëm



June 23, 2022

Kurti para pak ditësh gati sa s'i mori meritat për liberalizimin...



June 23, 2022

Çitaku: Gazi lotsjellës e molotovët na e humbën liberalizimin e vizave...



June 23, 2022

Ish-ministrja e Integrimeve Evropiane e fajëson VV-në për mos-liberalizim vizash: E...



June 23, 2022

Presidenca për liberalizim vizash: Ekziston mbështetja deklarative nga shumica e vendeve...



June 23, 2022

Lajm i keq: Nënvariantet e reja të Omicron janë rezistuese ndaj vaksinave



June 23, 2022

Shkodra viziton Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin: Drejtësia dhe e vërteta...

LAJME TË FUNDIT




Kurti para pak ditësh gati sa s'i mori...



Çitaku: Gazi lotsjellës e molotovët na e humbën...



Mësohet kalendari i La Ligas për sezonin e ardhshëm



Lajm i keq: Nënvariantet e reja të Omicron janë rezistuese ndaj vaksinave